



PROCESVERBAL 8 /2025

I mbajtur me rastin e mbledhjes së 8 (tetë) për vitin 2025 të Kuvendit të Komunës së Suharekës

Vendi:	Suharekë
Zyra:	Salla e Kuvendit të Komunës
Data:	29.08.2025
Ora:	10:00

Prezentë në takim:

Z. Shefket Kolgeci	Z.Vullnet Luzhnica	
Z.Selman Kolgeci	Z.Edon Sadikaj	Të pranishëm tjerë
Z. Flamur Bytyçi	Znj.Saranda Bajraktari	Kryetari Komunës
Z. Urim Suka	Znj.Mimoza Bajraktari	Media dhe qytetarë
Z. Kushtrim Kuçi	Znj.Festë Kabashi	OSCE, LMT, KDI
Znj. Elmaze Bytyqi	Z.Dardan Berisha	Znj.Habibe Bytyqi
Znj. Bulëza Kuçi	Z.Bajram Basha	Z.Xheladin Sadikaj
Znj.Doruntina Zenelaj	Znj.Mevlude Kabashi	
Z.Alban Berisha	Znj.Sheqerije Zyrapi	
Z. Xhevshet Gashi	Znj.Laureta Tafaj	
Znj.Sanie Kuçi- Rexhepaj	Z.Liridon Fandaj	
Z. Bexhet Kuçi	Z.Qëndrim Elshani	
Z. Reshat Selimaj	Znj. Afërdita Morina	
Z. Lirim Qatani	Z.Herolind Limaj	
Z. Aziz Bytyqi	Znj.Jehona Lumi	
Znj.Fidaije Kukaj	Rrafshi	

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Asamblesë Komunale z.Bexhet Kuçi,i cili propozoi këtë:

REND DITE

- 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar ;**
- 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e Planit të Veprimit Komunal për Strehim Familjar për Komunën e Suharekës;**
- 3.Shqyrtimi i projekt-Rregullores për bonuset e zonimit për Komunën e Suharekës ;**
- 4.Shqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin e vendimit 01-Nr-016-31320;**
- 5.Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Suharekës;**
- 6.Pyetje dhe përgjigje;**

Kryesuesi - e hedh në votim rendin e ditës.

Unanimisht Miratohet rendi i ditës

Doruntina Zenelaj - para 3 apo 4 seancave e kemi diskutu bashkarisht që me ardhë një draft për me i liru bizneset prej taksës në aktivitet.E di që është e rëndësishme për bizneset dhe nuk e shoh që e keni sjell.A mundet dikush me na informu se pse s'ka ardhë ky draft?

Kryesuesi - është e vërtetë që është diskutu por nuk e kemi prezent as Drejtorin dhe as Kryetarin.Në ndërkohë ndoshta vjen Kryetari dhe te pika e fundit mund ta parashtrosh pyetjen te Kryetari.

Pika 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 1.

Unanimisht Miratohet Pika1

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e Planit të Veprimit Komunal për Strehim Familjar për Komunën e Suharekës;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Dardan Berisha - edhe në KPF kemi kërku me pas një raport të bashkangjitur të këtij vendimi kur të vijnë pikat e rendit të ditë por nuk qenka as Drejtoresha e Shëndetësisë që me na dhënë një raport por si do çoftë ne duhte të vazhdojmë.

Kryesuesi - Drejtoresha e Shëndetësisë mungon dhe të paktën ka një përfaqësues të vetin nga DSHMS dhe në çoftëse ka ndonjë shënim sa i përket raportit që e kanë kërku anëtarët e Kuvendit,kisha kërku ta jepni nformacionin se si është gjendja.

Urim Suka - ne në parim sa herë jemi te këto planet që mbulojnë veprimtari të ndryshme,jemi për me i mbështet dhe unë e pata mendimin e njejtë pak a shumë me Dardanin që për ato që jeni zotu në KPF nuk kanë ardhë dhe do të ishte mirë m'i pa dhe me ditë se ku kemi qenë dhe cili është projeksioni se ku jemi duke shku dhe a ka nevojë për mbështetje shtesë lidhur me planin që po e votojmë.Nga DSHMS,në këtë rast nga Drejtoresha e Shëndetësisë si sponzorizuese do të donim që ajo të ishte prezente dhe të na jepte detaje pak më shumë që këtë vendim që sot po e marrim,ta marrim sa më të mirë dhe ti dalim në ndihmë secilës familje që e kryen një shërbim të tillë.Si LDK e mbështesim në parim por do të donim që të kishim një pasqyrë më të qartë.

Liridon Fandaj - ne këtë plan-veprim e mbështesim por në analizën që i kam bërë dhe ato që i thanë kolegët sa i përket raportit që është dasht ta sjellin por nuk e kanë sjell, unë i kam 5 vërejtje të këtij plan-veprimi. Financimi dhe qëndrueshmëria buxhetore; -ky plan nuk parasheh ndonjë qëndrueshmëri buxhetore dhe nuk janë saktë të specifikuar se cilat janë kostot për këtë plan-veprimi. Kapacitetet njerëzore; -ne përballemi me një mungesë të stafit të QPS-së ku aktualisht janë vetëm 5 punonjës dhe në anën tjetër ky staf duhet me mbikqyr këtë plan-veprimi. Nuk parashihet një mekanizëm monitorimi nga Asambleja apo nga KPF që do të ishte mirë të raportohet në këto dy institucione. Aty shihet që janë përfshirë edhe bashkëpunimet me SOS fshatrat por nuk specifikohet konkretisht cilat janë bashkëpunimet me këto OJQ mes tyre. Tjetër është aspekti ligjor dhe administrativ ku disa masa të propozuara, si lirimi nga pagesa komunale kërkojnë vendime të veçanta, dhe në këtë plan të veprimit janë vetëm të përmendura por pa kalu këto vendime në Asamble nuk mundemi ne me i liru prej taksave vetëm me këtë plan-veprimi.

Kryesuesi - e cekë që në buxhet nuk e kanë parapa. Unë besoj që në qarkorën që tash është duke u përgadit, këta do ta parashohin në qarkorë që me qenë një buxhet për implementimin e këtij plani.

Besmir Ibali-përfaqësues nga DSHMS - sa i përket raporteve që kërkuat, nuk kam ndonjë raport prej Drejtoreshës siq keni kërkuar. Ky plan është hartu prej ekspertëve në fusha të ndryshme. Ky plan është punuar edhe prej ekspertëve nga jashtë siq kanë qenë edhe SOS fshatrat të cilat kanë hartuar edhe plane tjera të cilat kanë qenë në dobi për komunitetin në përgjithësi. Plan i është i rëndësishëm dhe uroj të aprovohet nga të gjithë.

Liridon Fandaj - te kapacitetet njerëzore të QPS-së janë vetëm 5 punonjës ndërsa plani parasheh vizita monitorimi, trajnime dhe aktivitete. Si e kanë mendu këtë monitorim me bërë?

Besmir Ibali - unë kam punuar 5 vite në QPS dhe 5 persona janë staf dhe besoj që janë mjaftueshëm në raport me rastet të cilat janë për momentin. Te strehimi të familjet strehuese për momentin sipas statistikave që kam marrë në QPS në vitin 2025 janë vetëm 2 fëmijë të strehuar në familjet strehuese ndërsa në strehim familjar janë rreth 20.

Liridon Fandaj - nëse nuk i parashohim këto veprime, ky plan mund të jetë vetëm në letër por jo të implementohet në teren.

Besmir Ibali - sa i përket anës profesionale në bashkëpunim me SOS fshatrat do të kemi edhe trajnime e punëtori të cilat do ta trajnojnë stafin lidhur me këtë çështje.

Avni Bytyqi - Liridoni i ngriti dy çështje shumë të rëndësishme por unë besoj që janë të rregulluara edhe në aspektin ligjor për arsye se nëse e shohim në fund të këtij plani të veprimit, shihet qartë që komuna ka për obligim që ta formojë një grup punues për monitorimin e këtij plani të veprimit për periudhën që është paraparë. Atëherë vendos ky Kuvend që ta lejojë Kryetarin ta themeloj grupin punues për monitorimin e këtij plan veprimi apo do të të formohet nga Kuvendi i Komunës. Sa i përket lirimit të taksës në aktivitet apo pagesave për kryerje të shërbimeve, ne në vendimet e Asamblesë një kategori të personave me kategori të veçanta i kemi të liruara dhe në momentin kur ky plan i veprimit merr fuqinë ekzekutive, ne si kuvend apo si ekzekutiv kemi për obligim që të gjitha shërbimet që ofrohen falas për këto kategori, ti sjellim në kuvend dhe të marrim vendim në Kuvend që të miratohet si i vetmi organ për lirimin dhe caktimin e taksave në aktivitet është kuvendi i komunës me propozimin e akterëve kryesor të ekzekutivit.

Jehona Lumi Rrafshi - nëse familjarët e këtyre fëmijëve nuk pajtohen me strehimin, a keni paraparë ndonjë kriter se si do të veprohet në këtë situatë? Duke pas parasysh gjithëpërfshirjen e strehimit dhe mirëqenies sociale, nuk kam vërejtur që ka të bëjë edhe diçka me arsimin e këtyre fëmijëve. A janë disa kriterë të caktuara apo e keni bërë si gjithëpërfshirje?

Besmir Ibali - strehimi familjar tek të afërmit: nëse nuk pranojnë atëherë janë familjet strehuese ku për momentin në komunën e Suharekës janë dy të cilat paguhen nga komuna dhe një është në procedurë të licencimit.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 2.

Unanimisht Miratohet Pika 2

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-Rregullores për bonuset e zonimit për Komunën e Suharekës ;

Kryesuesi - elaboron pikën dhe hap debatin.

Urim Suka - është hera e katër që për temën e njejtë dalim në foltore dhe diskutojmë bashkarisht dhe

në fund rezultati i këtyre diskutimeve rezulton me moskalimin e këtij dokumenti. Ne si grup i LDK-së që nga seanca e parë që është diskutuar kjo temë, në të dytën e të tretën dhe sot kur jemi këtu, kemi shprehur vullnetin që kjo çështje të merr epilogun dhe të kalojë. Në asnjë rast nuk e kemi gjetur gadishmërinë e pushtetit që kjo temë të analizohet bashkarisht dhe në fund të vijë me një dokument të unifikuar, të përbashkët dhe t'ju japim ndërtuesve dhe qytetarëve këtë dokument që ata tashmë po e presin që një kohë. Unë sot në emër të grupit po kërkoj mirëkuptimin e të gjithëve që me marrë një pauzë 15 minutëshe dhe me u mbledh përfaqësues të gupeve parlamentare, të ulemi dhe ti armonizojmë qëndrimet dhe ti japim këtij dokumenti votën e përbashkët pro sepse është dokument që u shërben të gjithë njerëzve pa dallim partie.

Aziz Bytyqi - është fakt që kjo rregullore po vjen që disa herë. Me sa kam kuptuar i ka ndjekur të gjitha procedurat dhe është hartuar nga ekspertë të fushave përkatëse dhe si e tillë është dakorduar edhe me ministrinë e linjës. Nuk jam brenda fushës time profesionale dhe nuk jam që mos t'bëhen ndryshimet e mundshme dhe të nevojshme por me sa kam kuptuar unë çdo ndryshim e bën këtë dokument të kthehet si jo në pajtueshmëri me ligjin. Andaj besoj që debati është shterr për këtë temë dhe unë besoj që është interesi i qytetarëve dhe investitorëve që ta kalojmë të gjithë këtë çështje.

Dardan Berisha - realisht edhe duhet mu pajtu me atë që tha Urimi por kjo është hera e katër që vje në kuvend dhe duke e konsideruar prej ekzekutivit që është kaq e rëndësishme, ekzekutivi nuk ka gjetur vullnet që 5 muaj me na thirr as neve si asambleist dhe as shefat e grupeve edhe pse ka premtur që ka me na thirr. Unë nuk e di çka mund të bëjmë ne për 15 minuta! Unë jam pro kësaj pike dhe kam qenë pro prej fillimit.

Liridon Fandaj - këtë thirrje që e bëri kolegu nga opozita, do të duhej ta bënte ekzekutivi. Ekzekutivi nuk ka qenë i gatshëm asnjëherë me na ftu dhe me i bërë ndryshimet që i kemi kërkuar. Ne nuk kemi qenë kundër bizneseve dhe as kundër qytetarëve por ka qenë mosgadishmëria e ekzekutivit. Nuk kemi nevojë për 15 minuta sepse nuk ndërrohet rregullorja për 15 minuta.

Urim Suka - në qoftëse ju jeni në gjendje me kalu rregulloren sipas variantës tuaj, është dasht ta kaloni herën e parë dhe jo me ardhë në mbledhjen e katër për këtë çështje. Për shkak që kjo s'ka kalu që tri herë dhe për shkak të asaj që ne prej ditës së parë kemi pas disa propozime konkrete për këtë rregullore për me kalu dhe asnjëherë s'na keni ndëgjuar, për shkak që ju vet keni thënë që do t'ju thirrjmë dhe s'na keni thirrur, ne e kemi bërë një përpjekje ku edhe ato biznese që kanë kërkuar seancë të jashtëzakonshme, i kemi ftuar, kemi provuar me sqaru qëndrimin tonë dhe në vazhdimësi jemi për bashkëpunim për me krye këtë temë. Ky 15 minutëshi normal që nuk bëhet sot krejt po të mos ishin idetë prej takimit të parë. Grupi i LDK-së që në takimin e parë ti kanë dhënë këto propozime. Ne i kemi gati në letër dhe dokumenti është gati i cili pret me miratim.

Selman Kolgeci - pajtohem me Azizin që tha nuk jam ekspert i fushës. Tha që është në harmoni me ligjin dhe kam një pyetje. A mund të na tregoj se si përfundon pika 2 dhe pika 3 e nenit 6 të kësaj rregullore?

Kryesuesi - unë do ta hedh në votim propozimin e Urimit dhe nëse kalon, lus shefat e grupeve të qëndrojnë në sallë për bisedime.

Urim Suka - se çfarë propozime bëjnë grupet, le të jetë në vullnetin e grupeve. Qëndrimi i grupit tonë është qëndrim i unifikuar dhe këtë dokument e kemi të shkruar dhe mund edhe t'ua ofrojmë.

Kryesuesi - e hedh në votim propozimin për 15 minuta pauzë.

12 për, 13 kundër, 5 apstenime, propozimi nuk kalon.

Selman Kolgeci - tentimet për me kalu rregulloren në këtë formë janë trysni e drejtëpërdrejtë ndaj asambleistëve dhe mosgadishmëria për ta plotësuar këtë rregullore është mashtrim i pastër ndaj bizneseve dhe ndaj pronarëve të tokave se kinse pushteti është pro që kjo rregullore me kalu. Siq dihet ju as nuk doni e as nuk dini me kompletu një dokument të tillë. Andaj nuk e votojmë këtë rregullore.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 3.

15 për, 13 kundër, 1 apstenim, Miratohet pika 3

Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin e vendimit 01-Nr-016-31320;

Kryesuesi - elaboron pikën dhe hap debatin.

Urim Suka - pak më herët te propozimi jonë,thatë që kjo mundet mos me kalu e tash është një vendim që është kthyer prej atje dhe gati secilën mbledhje është nga një vendim që po ktheht.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 4.

19 për,Miratohet pika 4

Pika 5. Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Suharekës;

Kryesuesi - elaboron pikën dhe hap debatin.

Liridon Fandaj - vet vonesa e sjelljes së këtij raporti tregon seriozitetin apo mangësitë e Kryetarit i cili në raportet e mëhershme nëse ka marrë një opinion tjetër ka dal dhe e ka proklamuar që opinionin është i mirë e të gjeturat do ti përmirësojmë por nga viti në vit veq ka shku më keq.

Opinionin është i kualifikuar.Dëshmi,mangësi serioze në menaxhim të financave.Keqklasifikim i 2.5 milion eurove.Paga,shujta për mësimdhënës duke pagu edhe nga investimet kapitale.Obligime të papaguara në vlerë 42.000 €.Zhvendosje e 305.000 € të projekteve kapitale pa aprovim të Kuvendit por me vendim të Kryetarit.Prokurimi me specifika dhe me tender për favorizim të kompanive.Përdorimi i gabuar i kontratës publike Korniz për ndërtim rrugësh.Subvencione të ndara jasht kriterëve,përfitues pa tokë sipas kushteve.Mungesë projekte ekzekutive për disa investime kapitale.Vetëm 10.5% e pronave është verifikuar,në vend se të ishin 20% ashtu si e kërkon ligji.Pasuri jo kapitale 45.000€ të paregjistruar në sistem.Vonesa në pagesa në vlerë 135.000€,rrezik për kamata dhe gjyqe.Paga pa evidence vijueshmërie të zyrtarëve komunal.Mbi 8 milion euro llogari të arkëtueshme pa strategji për inkasim.Raportim i mangët për pronat komunale të dhëna në shfrytëzim.Projekte madhore të vonuara.Jo serioziteti i këtij ekzekutivi tregon edhe sot ku Kryetari nuk vjen të ballafaqohet me ne për raport me një opinion ku s'ka më keq dhe po ashtu edhe Drejtori i Ekonomisë nuk e ka pa të rrugës as në KPF por as në Asamble me ardh me u përball me pyetjet dhe kritikën tona.

Kryesuesi - unë e ceka që është një dokument dhe është i besueshëm ky raport ashtu si e kanë parapa auditorët dhe për shkak të gjendjes që është kriju,ju e dini që kontrata kolektive e ka bërë vetën dhe jo vetëm në komunën tonë por edhe në komunat tjera dhe shpresoj të ardhmen mos të përsëriten këto.

Liridon Fandaj - mos mundohi me mbulu Kryetarin sepse do t'ishte shumë më e rëndësishme me ardhë këtu se sa me bërë edhe një keqpërdorim,me shku në Gallushë të Peqanit dhe me qel një rrugë që nuk e ka në plan as të planifikuar.

Selman Kolgeci - ky raport i auditorit për vitin 2024 është dëshmia më e qartë se qeverisja lokale në Suharekë ka dështuar rëndë në menaxhimin e parasë publike dhe projekteve kapitale.Nuk është fjala për interpretime politike por për një dokument zyrtar i cili knfirmon atë që ne e kemi thënë vazhdimisht.Raporti përmban 19 rekomandime,10 të reja dhe 9 të përsëritura.Kjo tregon që komuna në vend që të përmirësohet është duke i përsërit gabimet vit pas viti.Në këtë raport janë evidentu keqklasifikime të shpenzimeve mbi 2.5 milion euro ku paratë e destinuara për investime janë përdorur për gjëra tjera.Kjo e shtrëmbëron raportimin financiar dhe mashtrohet qytetarët mbi realitetin e buxhetit sepse siq dihet ju jeni krekos para qytetarëve se kinse keni arrit vlerë të lartë të përqindjes së shpenzimeve të parave në investime kapitale.Kjo tregon që këto investime nuk kanë shkuar për investime kapitale.Janë bërë ndryshime në projekte kapitale në vlerë prej 305.000 € pa aprovim të kuvendit.Pra Kryetari e ka trajtu buxhetin si buxhet personal.Në disa tenderë janë specifikuar emrat e prodhuesve,praktikë kjo e ndaluar që dëmton konkurrencën dhe i favorizon disa kompani të caktuar por e keqja është që kjo nuk është e vetmja shkelje e zyrës së prokurimit.Ne kemi pas vërejtje vazhdimisht sa i përket asaj zyre dhe po përmbyllet mandati jonë si asambleist dhe menaxheri i asaj zyre asnjëherë nuk ka ardhë këtu me raportin për procedurën se si kanë shku kontratat.Rast tjetër i keqmenaxhimit nga kjo zyrë dhe nga kjo qeverisje është kontrata për ndërtimin dhe rikonstruimin e rrugëve që e keni shkru me çmime njesi.Si ka mundësi me u rikonstruudhe me u rindërtu një rrugë me çmime njesi?kur dihet gjatësia,gjerësia dhe krejt elementet e sigurisë që i duhet asaj rruge.Janë dhënë subvencione për sera pa i përmbushur kriteret e shpallura duke favorizuar individë të caktuar dhe duke diskriminuar fermerët të ndrrshëm,e kjo nuk është vetëm për sera por edhe për mekanizma bujqësor.Keni vendos vet kriteret dhe vet ato kriteret i keni shkel.Në disa projekte kapitale në vlera qindra-mijëra euro është vërtetuar mungesa e projekteve ekzekutive.Pra,investime pa plan,pa llogari

dhe me rrezik të madh për dështim. Vonesa në projekte.Në tri projekte deri në fund të vitit 2024 janë mbi 1000 ditë vonesa që janë marrë mostra nga auditor i përgjithshëm.Kjo analizë e raportit na tregon se kemi të bëjmë me një qeverisje lokale që dështimet i përsërit,gabimet i fsheh ndërsa paratë publike i keqpërdor pa transparencë.Kryetari dhe ekipi i tij nuk mund të arsyetohet më sepse raporti i auditorit e ka zhvesh nga çdo justifikim.

Urim Suka - ne sot po diskutojmë për raportin e auditimit ku adresohen një mori gjetjesh të ndryshme dhe Kryetari i komunës nuk e ka marrë mundin me qenë sot i pranishëm dhe m'i dhanë përgjigje këtyre gjetjeve,por edhe një pjesë të drejtorave sot nuk i kemi këtu.Dje deri sa po merresha me materialin për Asamble pash një postim propagandues të Kryetarit ku ndër tjera thoshte: e di që ju shqetëson përballja me ta,sidomos kur flasin keq e me inate,etj. Ky postim është thjesht dhe si çdo herë përpjekje e madhe për të larguar qytetarin nga e vërteta.Nga e vërteta që vetëm një pjesë e vogël tregohet në këtë raport sepse e vërteta është më keq se ky raport i keq që ka ardhë për këtë qeverisje.Kryetar,e vërteta është ajo që ju shqetëson ose do të duhej t'ju shqetësonte përballja me të gjeturat e këtij raporti.Gjithëashtu do të duhej t'ju shqetësonte përballja me të gjeturat tona tash e 4 vite.Ne nuk flasim keq,as me inate por për 4 vite kemi folur me argumente e fakte.Në këtë raport janë 19 rekomandime ku prej tyre janë 10 rekomandime të reja dhe 9 të përsëritura.Kjo do të thotë që këto 9 gjetje që nga viti i kaluar e keni ditë që janë shkelje dhe ju keni vazhdu ti bëni të njëjtat prapë.Ndër gjetjet është edhe ndryshimet në shumat e ndara buxhetore të projektet kapitale pa aprovim të Kuvendit komunal.Ne në vazhdimësi kemi thënë që ky ekzekutiv e ka anashkalu Kuvendin komunal.Në shumë projekte që janë miratu nuk janë ekzekutu nga ekzekutivi sipas planit e kontratave që vet i keni hartu. Mosrespektimi i kriterëve të përcaktuara në thirrjen publike për subvencionimin e fermerëve me sera në bujqësi.Mungesa e projekteve ekzekutive.Gjetja për mungesat e projekteve ekzekutive janë nga viti në vit.Kjo ka ndiku që me pas këtë cilësi që e kemi tani,që në secilën punë që e keni bërë cilësia lë shumë për t'u dëshiruar dhe duhet intervenime prap.Vonesa në pagesat e obligimeve.Raporti i auditorit thotë që ky ekzekutiv ka vonesa edhe pse ka pranuar faturat,nuk i ka kryer pagesat me afatin prej 30 ditësh dhe kjo sigurisht i krijon angazhime shtesë ose obligime shtesë komunës për shkak se mund të ketë ankinime nga operatorët.Vonesa në realizimin e projekteve.Në shumë projekte ku një ndër to edhe rruga "Skënderbeu" ku aty afati është 53 ditë ndërsa u tha që kanë kalu 1000 ditë.Pra,ka pas vonesa në implementimin e atij projekti e mos të flasim për cilësinë dhe për mungesën e hapësirave që rrezikon lëvizjen e qytetarëve me mungesat e trotuareve. Të dashur qytetar e di që s'keni harru dhe i mbani mend ato që kam thënë për 4 vite.Secila nga ato që kam thënë është e vërtetë,e bazuar në fakte e argument konkrete.Megjithatë edhe unë ju ftoj të respektoni mendimin e lirë por mos harroni se e vërteta dhe propaganda janë dy gjëra të ndryshme.Natyrisht respektoni edhe njëri tjetrin dhe asnjëherë mos largohi nga e vërteta ndërsa një pjesë e të vërtetës për këtë qeverisje është në këtë raport.Të vërtetën e plotë e kemi thënë për 4 vite.

Doruntina Zenelaj - unë personalisht nuk dua të përmend një nga një të gjeturat në këtë raport sepse ato janë qartë të lexueshme dhe qartë të kuptueshme për secilin person.Dua të shpreh disa shqetësime që i kam vërejt tek raporti i auditimit.Shqetësim i madh është që shumica e gjetjeve në këtë raport kanë të bëjnë me keqmenaxhim financiar që nënkupton se Kryetari i komunës nuk e ka një pasqyrë të saktë të parasë publike që e zotëron komuna jonë.Nuk e din sa janë borgjet,nuk e din sa ka detyrime ndaj operatorëve,nuk i shpenzon paratë nga ndarjet konkrete buxhetore etj.Tjetër shqetësim i madh është fakti që komuna jonë ka degraduar me parregullsi shumë më shumë krahasuar me vitin e kaluar.Kjo për faktin se nëse e analizojmë raportin e auditimit të vitit të kaluar,aty kanë qenë 10 gjetje kurse në vend se në këtë raport të kishim përmirësim,tani kemi 19 gjetje.Përveq që ne kemi degraduar në numrin e gjetjeve dhe se raporti i auditimit nuk është marrë fare seriozisht nga Kryetari,është edhe fakti se nga 10 rekomandime për përmirësim në raportin e kaluar janë identifikuar 9 nga to të cilat Kryetari nuk i ka trajtuar fare por ka trajtuar vetëm një nga ato rekomandime dhe e ka trajtuar pjesërisht.Shqetësimi tjetër në këtë raport ka të bëjë edhe me faktin se 19 gjetjet e identifikuar në këtë raport për 16 nga to Kryetari është pajtuar se janë gjetje reale dhe se ka pasur ngecje apo keqmenaxhim.Vetëm për tri nga to nuk është pajtuar dhe vetëm për tri nga to ka dhënë një arsytim i cili arsytim len për tu dëshiruar.Nëse analizohet çështja b3 në faqen 12 dhe 13,shihet qartazi se analiza është bërë nga 59 mostra ku 23 raste është konstatuar se janë respektuar hapat për procedimin e pagesave e që vlera e pagesave për të cilat nuk janë respektuar hapat arrin vlerën prej 1.173.776 €.Nëse bëjmë një analizë të këtyre shifrave konstatohet se nga mostra ka rezultuar se rreth 50% të pagesave janë kryer pa respektimin e hapave të duhura.Pramendoni sikur të ishin analizuar të gjitha

rastet e pagesave apo sikur ti fusim të gjitha pagesat në kalkulim me marzhe gabimi prej 50% ,vlera e gabimit do të ishte shumë më e madhe dhe për mendimin tim shumë shqetësuese.

Pika 6. Pyetje dhe përgjigje;

Shefket Kolgeci - ju falemnderoj të gjithëve për bashkëpunimin që kemi pas ndër këto vite e sidomos mandatin e fundit dhe respektin që keni tregu ndaj meje.Gjithëashtu edhe unë jam mundu të sillem korrekt me juve dhe unë më nuk do të jem në Asamblëtë e ardhshme.Kemi pas debate,ashpërsi,kundërshtime e mendime të ndryshme por këto janë të lejuara në demokraci dhe asnjëherë personale s'kam pas me asnjë por gjithnjë kam mendu në interesin e qytetarëve e pastaj të partisë.Dua ta bëj dhe një pyetje për DSHPE.Ka fillu rruga e Antenës në Vraniq dhe ka shqetësim nga qytetarët atje.Kërkoj të di sa është projekti dhe sa ka kushtu?Ne e kemi ditë që 1 kilometër ka m'u shtru ndërsa punëkryesi ka thënë që do të shtrohen vetëm 800 metra.

Kryesuesi - falminderit për fjalët doktorr.Edhe ne jemi mirënjohës për punën dhe angazhimin tend.

Avni Bytyqi - edhe në KPF është ngrit një shqetësim se a do të jetë edhe një seancë apo nuk do të jetë.Pavarësisht zgjedhjeve që janë,institucionet kanë me funksionu normal pa asnjë pengesë ligjore përpos atyre kufizimeve që i parasheh ligjet e veçanta.Zyrtari ligjor tutje jep sqarime.

Enver Shabani - sa i përket pyetjes për rrugën te Antena në fshatin Vraniq,është e vërtetë që kemi nda një buxhet prej 100.000€ ku i kemi udhëheq të gjitha proedurat e prokurimit.Nuk e di vlerën e saktë të kontratës por e di që 800 metra rrugë do të shtrohen me asfalt.Drejtori tutje jep sqarime.

Shefket Kolgeci - u shkurtu rruga për 200 m dhe qytetarët kanë shqetësim.Pse me u shkurtu 200m?

Enver Shabani - për me bë 1 kilometër asfalt për dallim nga viti i kaluar që janë bë me 100.000€,këtë vit nuk bëhen me 100.000€ sepse çmimi për asfalt është rrit.

Urim Suka - unë e kam diskutu edhe më parë, bëhet fjalë për rrugën Dugagjini të cilën e keni shtru tash vonë ku një prej banorëve aty e ngriti prap shqetësimin që e ka pas me fillim.Rruga është dëmtu edhe më shumë.Dua të di a ka ndonjë kontratë për mirëmbajtje që mundet dikush me rregullu sepse gati është bë e pakalueshme prej dëmtimeve që janë bë.Pyetja e dytë ka të bëjë me DKA-në ku konkursi që është hap për rekrutimine mësimdhënësve dhe nga një informatë që e kam marrë unë,me një rast një mësimdhënës i gjuhës shqipe del në pension me 15 shkurt dhe konkursi është hap 6-7 muaj përpara.Qëllimi është i keq për shkak se po pretendohet me u përdor elektoralisht.Dua interpretim nga zyrtari ligjor se a ka të drejtë 6 muaj përpara me u hap konkursi për një vend që ka me dal në shkurt.

Enver Shabani - ne e kemi një kontratë për sanimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve dhe sigurisht në planifikimet tona ka me qenë edhe rruga Dugagjini.Është hera e pare që po e dëgjoj zyrtarisht këtë shqetësim por ne jemi të obliguar me dal në teren dhe ta shohim gjendjen e rrugës.

Urim Suka - është hera e dytë që po e adresoj dhe keni mujt me i marrë masat e nevojshme por nuk i keni marrë.Ajo nuk është dasht as m'u pranuar ashtu siq është bë.

Avni Bytyqi - zyrtari ligjor jep sqarime sa i përket pyetjes dhe thotë që nuk ka ndonjë kufizim ligjor apo bazë ligjore që e rregullon se kur duhet të hapet konkursi por megjithëatë kërkohet që të merret konfrmimi edhe nga MAPL dhe të merret konfirmimi edhe nga ZKF se a ka mjete të planifikuar për konkursin që është shpall.Besoj që njësia e burimeve njerzore e komunës sonë i ka marrë këto konfrimime dhe mendoj që drejtorja në këtë rast ka vepruar mirë.

Urim Suka - mua më kujtohet vitin e kaluar kur ka shku 10 shtatori dhe kanë qenë një mori konkursesha,nuk janë zgjedh stafi.Atëherë nuk ka qenë vit elektoral dhe DKA i ka vonu procedurat dhe ka pas shumë humbje të orëve në atë kohë.Ju po e hudhni te burimet njerëzore por unë mendoj që as burimet njerëzore dhe askush tjetër,pa i shku një njoftim apo kërkesë prej DKA-së askush nuk mundet me shpall konkursin.Unë mendoj që për me u shpall një konkurs për një mësimdhënës të caktuar për shkak se ai del në pension,DKA fillimisht duhet ta pranojë dhe një njoftim nga shkolla e pastaj DKA m'i ndjek procedurat.Unë do të interesohem për këtë rast,që shkolla a i ka dërgu njoftim DKA-së paraprakisht.Po vërehet që kjo është për qëllime elektorale.

Liridon Fandaj - Ndërtimi i rrugëve lokale në Peqan në projekt-buxhet është: Ilir Konushevci-segment,Ahmet Sefa,Emona,Muhamet Krasniqi,Jashar Shasivar Bytyqi ku këto rrugë me një buxhet 35.000€ nuk e di a do të mund të shtrohen por kam një shqetësim qytetar që po shtrohet rruga Muhamet Krasniqi dhe nuk po shtrohet rruga që taman e ka atë emër por po shtrohet një rruga private e në këtë rast ka rastisur që ajo është e miqve të Drejtorit të Urbanizmit.Unë vet nuk e kam pa por

është shqetësim i një qytetari. Dua të di, a ka mundësi me 35.000€ me u shtrë gjithë ato rrugë dhe a do të përfundojnë ato pasi janë të planifikuara? Kam një kërkesë tjetër qytetare te rruga “Hamzi Bytyqi”. Është një mur që është i dëmtuar dhe rrezikon qytetarët aty. A ka mundësi me ndonjë fond ose ndonjë buxhet shtesë me riparuar atë ose me bo një zgjidhje.

Visar Kuçi - ata nëse janë miqtë e mi, a janë qytetarët e RKS-së, a janë të fshatit Peqan? Nëse është rruga Muhamet Krasniqi, a është e paraparë në buxhetin e komunës së Suharekës për vitin 2025? Çdo qytetari që i shtrohet një rrugë apo një kanalizim me taksa të tyre, është shumë e mirë.

Enver Shabani - nuk e di a do të kryhen këto rrugë me 35.000€ por aq është buxheti për fshatin Peqan dhe varësisht nga paramasat që bëhen, aq sa ka mjete aq shtrohen. Sa i përket murit mbrojtës deri para 4 -5 viteve çdo herë komuna e Suharekës e ka pas një buxhet me një kod të veçantë emergjent dhe në momentin që e ka ndal qeveria, komuna nuk ka mundësi me i dal në ndihmë qytetarëve.

Liridon Fandaj - shumë më emergjente është ajo sepse mund të ndodh një fatkeqësi se sa një rrugë në Gallushë.

Enver Shabani - ajo rrugë është e planifikuar.

Jehona Lumi Rrafshi - kam dy shqetësime nga qytetarët. Pse ndriçimi te këndi i lodrave në fshatin Bllacë te bregu nuk është funksional mbi 2 muaj. Ata nuk janë të dëmtuar nga qytetarët. Shqetësim tjetër është rruga “Rrafshi” në Duhël ku atje është një gjendje katastrof dhe mendoj që urgjentisht duhet të bëhet sanimi i asaj rruge për shkak që i lidh të dy fshatrat. Drejtor, kur do të bëhet sanimi i kësaj rruge dhe kur do të rregullohet ndriçimi tek këndi i lodrave në Bllacë?

Enver Shabani - rruga Rrafshi që lidh Duhël me Malishevën është rrugë regjionale dhe ne nuk mund ta rregullojmë atë me asfalt. Bëni kërkesë te Liridoni që ti bën në instanca pak më të larta këto kërkesa.

Liridon Fandaj - unë nuk e përfaqësoj qeverinë por i përfaqësoj qytetarët e komunës tonë.

Jehona Lumi Rrafshi - për deri sa jam Drejtor i DSHPE dhe është një ankesë e qytetarëve dhe m'u adresu direkt në Ministri, nuk pe shoh të arsyeshme. Duhesh me gjet lidhjen e bashkëpunimit të paktën prej anës tënde.

Enver Shabani - nuk kemi bashkëpunim të mirë me qeverinë dhe s'ka qeveri që 7 muaj. Sa i i përket ndriçimit publik zotohem që nëse ka ndonjë defekt do të rregullohet shumë shpejt.

Jehona Lumi Rrafshi - ky informacion ka qenë edhe më herët. Pse nuk keni ardh mi kqyr?

Enver Shabani - e kemi një ekspert të ndriçimit publik i cili vjen nga rajoni juaj. Ai del shumë në teren por jo gjithmonë jemi edhe aq të saktë.

Saranda Bajraktari - unë po lidhem me pyetjete e Jehonës. Sinqerisht ato dy gropat te lagjja Rrafshi që fatkeqësisht është rrugë magjistrale që nuk po e merrni si përgjegjësi. Dje isha një dëshmitare e një aksidenti që do t'ishte duke u bërë në mënyrë katastrofale. Ne s'po thojmë me shtrë komplet atë magjistrale por dy gropat aty mundeni mi mbulu.

Qëndrim Elshani - te puna e parkut të lojërave te ish pazari, të gjithë lojtarët që luajnë tenis në komunën e Suharekës thojnë që ajo fushë e tenisit nuk është e punuar siq duhet. Është mirë me shku me rregullu atë fushë dhe me bërë funksionale. Kërkoj të di prej jush se kur do t'ja nisni ta rregulloni atë fushë.

Visar Kuçi - Drejtoresha e Kulturës është marrë me atë projekt por nëse ka ndonjë defekt unë e di që kompania ka një garancion dhe mund ta kontrollojmë bashkë.

Urim Suka - çështja që diskutoi Saranda dhe Jehona e kam ngrit edhe unë si shqetësim. Drejtor, rruga Skënderbeu e ka statusin e njejtë dhe krejt ia keni ndërru formën dhe keni pas të drejtë me investu aty. Dy gropat s'po mundesh me i ndryshu. E ke një kontratë për mirëmbajtje dhe nuk vje ministria me të thanë pse e rregullove. Te pjesa e ndriçimit që ngriti Jehona, mua më është thënë që ato llampat ndriquese janë hargju në pozicion dhe për shkak të saj s'kanë arrit me i rregullu dhe është mirë me i rregullu si pozicion.

Qëndrim Elshani - a është bërë pranimi teknik i asaj fushe? Nëse po, si keni pranuar një diçka jashtë normave?

Visar Kuçi - pranimi i pare i një projekti bëhet me raport të fundit. Ajo fushë ka leje ndërtimore dhe ka një garancion dhe ka pas një projekt. Ne duhet ta kontrollojmë dhe nëse specifikat i ka pas operatori ekonomik për me shtrë aso fushe, nuk ka të bëjë me operatorin por nëse i ka ndryshu ne duhet të mirremi. Ne do të kontaktojmë me menaxherin e projektit dhe besoj e rregullojmë. Sa i përket rrugës në Bllacë, është fakt që është rrugë e ministrisë dhe ministria e ka një kontratë për mirëmbajtjen e rrugëve

dhe se ne e kemi një bashkëpunim të mirë me mirëmbajtjen e rrugëve. Ne do të kontaktojmë me ministrinë dhe nëse ministria nuk mund ti mbyll ato dy gropat, do ti mbyllim ne. Rrugët edhe pse janë të qeverisë kur janë në zonë urbane, ne duhet m'i rregullu.

Urim Suka - e falemnderoj drejtorin që e mor obligimin për me rregullu atë pjesë. Në qoftëse është kompetencë e ministrisë, kur ne e adresojmë, ti si drejtor DSHPE duhet m'i bë shkresë ministrisë dhe nëse ata nuk e kryejnë duhet me kry ti sepse po flasim për sigurinë e njerëzve.

Qëndrim Elshani - Drejtori tha që këtu ka edhe projekt edhe leje. Pikërisht nëse i ka kalu filtrate e pranimit të parë, si ka mundësi që kjo fushë me qenë jo funksionale?

Visar Kuçi - shumë shpejt me menaxherin e kontratës dalim dhe e verifikojmë.

Liridon Fandaj - pyetje për Kryesuesin pasi je në komision për themelimin e Eko Therandës. Ne po i shohim disa punëtor që janë punëtor të Eko Therandës. A ka pas konkurs apo të kujt janë ata punëtor?

Kryesuesi - ata janë punëtor të Eko Therandës, janë marrë prej Eko Regjionit me një marrëveshje bashkëpunimi.

Liridon Fandaj - cila drejtori ka bërë marrëveshje bashkëpunimi me të dhe a mund ta shohim edhe ne atë marrëveshje.

Kryesuesi - ushtruesi i detyrës së kryeshefit ekzekutiv e ka bërë marrëveshjen dhe atje mund ta shihni marrëveshjen.

Liridon Fandaj - nëse bëhet marrëveshje bashkëpunimi do të duhej të bëhej një kontratë për shërbime por që i kryen Eko Regjioni por jo marrëveshje bashkëpunimi për punëtor.

Enver Shabani - punëtorët aktualisht janë punëtor të Eko Therandës. E kanë bërë një marrëveshje mirëkuptimi me punëtorët e Eko Regjionit sepse të njejtën punë kanë pas me punu. Komuna e Suharekës 136.000€ në vit ia ka dhënë Eko Regjionit për mirëmbajtjen e qytetit. Për mos me ia dhënë Eko Regjionit ato 136.000€, ia kanë dhënë Eko Therandës dhe Eko Theranda i ka marrë të njejtën punëtor me transfer në marrëveshje nga kontrata.

Liridon Fandaj - duhet me dal konkurs për ata punëtor por jo me marrëveshje.